

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“ACQUA” sh.p.k

Tiranë më datë 03/02/2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “ACQUA” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dale në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“ACQUA” sh.p.k**

NENI 3

Objekti i veprimit tarisë

Objekti i eprimit tarisë së shoqërisë është administrimi dhe menaxhimi i ambjenteve publike dhe private, komplekseve turistike, pushuese, banimi, administrimi dhe krijimi i strukturave të reja për kryerjen e shërbimit të Bar-Restoranteve.

Konkretnisht:

1. Krijimi dhe menaxhimi strukturave të Hoteleri-Turizëm, strukturave akomoduese
2. Krijimi dhe menaxhimi i strukturave Bar-Restorante, Fast-Food-e
3. Krijimi dhe menaxhimi të venteve socio-kulturore
4. Krijimi dhe menaxhimi dhe administrimi i stacioneve të plazhit, lundrime turistike
5. Krijimi dhe menaxhimi i pistave detare për aktivitete të ndryshme
6. Tregti, import-eksport mallrashrash dhe pajisjesh të ndryshme të cilat lejohen nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Lagja Nr. 9, Rruga “Isuf Ferra”, Durrës, Shqipëri.**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. **Z. Majk KULLA**, lindur në Durrës, Shqipëri, më 14.05.1998, identifikuar nëpërmjet Pasaportës nr. J80514068B, zotëruar i 20 (njëzet)% të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 2.000(dy mijë) Lekë, zotëruar i një kuote
2. **Z. Dritan MEMINAJ**, lindur në Belishovë, Shqipëri, më 07.02.1971, identifikuar nëpërmjet ID nr. H10207120N, zotëruar i 80 (tetëdhjetë)% të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 8.000 (tetëmijë) Lekë, zotëruar i një kuote

Kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Registrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese



Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Dritan MEMINAJ**, lindur më 07.02.1971, Shqipëri, shtetas **shqiptar**, identifikuar nëpërmjet ID me nr. H10207120N, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit finanaciar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqrissë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Majk KULLA



Dritan MEMINAJ

